



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 tetor 2011, në mbledhjen e XVI (gjashtëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.10.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Liman Zeqiri, Zyra Komunale për Komunitetet dhe Kthim z. Reshadija Regjepagiq dhe z. Valdete Bytyqi, Ministria për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë Podujevë, z. Nexhat Sekiraqa, Policia kufitare Veriu, z. Bekim Karagjija, OSBE , z. Istvan Torok, LMT – KFOR- Hungarez, z. Shqipe Durguti, Marija Joviq dhe z. Remzije Ibrahim, ICITAP – Departamenti i Drejtësisë, SHBA.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9 shtator 2011

Ekstrakti u miratua njëzëri.

3. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2011 – 2012, gjendja aktuale e nxënësve të komuniteteve ashkalinj dhe rom, sfidat dhe vështirësitë

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Jahë Lahu, paraqiti të dhëna konkrete për numrin e nxënësve të komunitetit ashkalinj dhe rom të cilët vijojnë mësim në shkollimin fillor dhe të mesëm dhe aktivitetet e ndërmarra për ngritjen e arsimimit të këtyre komuniteteve.

z. Nebih Behluli, theksoi, statistikën e paraqitura nga parafolësi janë reale mirëpo është e nevojshme të caktohen prioritetet për tejkalimin e vështirësive ekzistuese dhe atë në përcjelljen e vazhdueshme të vijueshmërisë në mësim ashtu edhe në

aspektin e regjistrimit në kl.X si dhe krijimin e praktikave efektive të bashkëpunimit me prind. Është për tu përshëndetur kryetari i këtij Komiteti që i ka siguruar librat për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të komunitetit ashkalinj dhe rom por edhe të disa nxënësve të komunitetit shumicë të cilët e kanë gjendjen e rëndë sociale.

Lidhur me mësimin shtesë që e përmendi z. Jahë Lahu, unë sugjeroj që në këtë proces të mos angazhohen kuadrot e vjetra por të angazhohen kuadrot e reja të cilët përdorin metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies.

z. Jahë Lahu, theksoi, dihet se fëmijët edukatën fillestare e marrin nga prindërit, mirëpo te komunitetet ashkalinj dhe rom problem paraqet fakti se nënat janë të pashkolluara, andaj është e domosdoshme të shqyrtohen mundësitë për hapjen e qendrave parashkollore ku do të përfshiheshin edhe nxënësit e këtyre komuniteteve.

z. Burhan Blakçori, nënvizoi, e falënderoj z. Jahë Lahun për informacionet e dhëna me shifra dhe numra konkret dhe shtoi, është mirë që për nxënës të shkollës fillore librat i siguron MASHT-i, gjithashtu e përshëndeti edhe kryetarin e këtij Komiteti i cili për nxënës të shkollave të mesme të këtyre komuniteteve ka siguruar librat e nevojshme.

Sipas të dhënave të paraqitura vitin e kaluar shkollor mësimet i kanë braktisur katër nxënës, ndërsa vitin aktual shkollor e ka braktisur vetëm një nxënës e kjo shënon trendë pozitiv, mirëpo brengosë fakti se në studime universitare nga këto komunitete është vetëm një student andaj në këtë drejtim duhet angazhim i veçantë.

z. Liman Zeqiri, nënvizoi, faktor kryesor janë kushtet e vështira ekonomike e sociale për qytetarët tanë në përgjithësi e në veçanti për komunitetet ashkalinj dhe rom, mirëpo përkundër kësaj vërehen trende pozitive.

Për mua brengë është që vitin e kaluar shkollimin e kanë braktisur katër nxënës të këtyre komuniteteve andaj në këtë aspekt duhet ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që në të ardhmen shkollimin të mos e braktis asnjë nxënës.

Meriton të përgëzohet Drejtorja e Arsimit e cila ka realizuar projektin në shumë 3.000,00 € me destinim për sigurimin e librave për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të komunitetit ashkalinj dhe rom por edhe për disa nxënës të komunitetit shumicë të cilët janë në gjendje të rëndë sociale.

Përgatitja parashkollore që tani po zbatohet është shumë e rëndësishme ngase kjo fëmijëve ju ndihmon në shumë aspekte dhe është e domosdoshme përfshirja e të gjithë fëmijëve në këtë fazë fillestare të arsimimit.

Kjo pikë e rendit të ditës u miratua njëzëri.

4. Të ndryshme

z. Remzije Ibrahimi, njoftoi se në kuadër të ICITAP – Departamenti i Drejtësisë, SHBA në 32 komuna të Kosovës janë formuar Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, në përbërje prej 30 – 35 anëtarë dhe se këto grupe janë të kombinuara prej përfaqësuesve të policisë, zyrtarëve komunal dhe bashkësisë në përgjithësi, grupe të cilat kanë kryer trajnime gjashtë ditore për identifikimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre në nivel komunal siç janë pastrimi i ambientit, dhuna familjare, eliminimi i qenve endacak, eliminimi i dukurisë së lëmosh kërkuesve

dhe të shtënave me armë zjarri në ahengje të ndryshme, përkujdesja ndaj marrëdhënieve të mira ndëretnike etj.

Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi si problem kanë identifikuar mungesën e integritit në sfera të ndryshme të komuniteteve ashkalinj dhe rom.

z. Fadil Babatinca, Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkës në Komunën e Podujevës deri tash i kanë realizuar pesë projekte në vlerë prej 25.000,00 € dhe në vitin 2011 vlera është në shumë prej 16.000,00 €.

Projekti i ICITAP-it është dëshmuar i suksesshëm me rezultate evidente ku përveç aktiviteteve tjera vlen të përmenden dhuratat për nxënësit e shkollave fillore në fshatrat Turiqicë dhe Llaushë.

z. Remzije Ibrahimi, nënvizoi, dua të ju njoftoj se brenda një kohe të shkurtë, me qëllim të ndërtimit të urave të bashkëpunimit, në Podujevë do të mbahet Tryezë e rrumbullakët me temën Integrimi i komuniteteve RAE.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësen e falënderoj për organizimin e Tryezës së rrumbullakët dhe kërkoi që për datën e mbajtjes informimi të bëhet me kohë.

z. Bekim Karaxhia, njoftoi se OSBE ka kontaktuar me kryetaren e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës dhe se ajo e ka pranuar ofertën që të mbajë një takim të përbashkët me Komitetin për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mirëpo për shkak të situatës aktuale ky takim do të shtyhet një kohë, por kur të përgatiten pikat e rëndësishme të rendit të ditës, OSBE do të ndërmjetësoj në organizimin e këtij takimi.

Në fund e përshëndeti ICITAP-in për iniciativën për mbajtjen e Tryezës së rrumbullakët me temë shumë të qëlluar.

Mbledhja përfundoi në orën 12.05'.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/166-06

Podujevë,

6 tetor 2011

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**